

Sipas embargos – E Mërkurë 20 Shkurt - 7:00 am (Ora e Parisit)



CRÉDIT AGRICOLE S.A.

Montrouge, 20 Shkurt 2013

Rezultatet për tremujorin e katërt dhe vitin e plotë 2012
Crédit Agricole kthen faqen dhe është tani në rrugë të drejtë
për të ofruar një performancë të qëndrueshme

Reduktimi i riskut, rregullim i shpejtë në mjedisin e ri

- dalja nga Greqia
- reduktimi i nevojave për financim dhe në aktivet me risk të ponderuar me tejkalimin e objektivave të planit të rregulluar
- përqëndrimi i operacioneve në Evropën Jugore
- efikasitet i operacioneve të zgjeruara

Rezultatet e raportuara pasqyrojnë ndikimin kontabël të operacioneve të jashtëzakonshme dhe një modifikim në taksimin e largimit të Emporiki

E ardhura neto e normalizuar që tregon elasticitetin e linjës së biznesit në një klimë të vështirë

Forcimi i aftësisë paguese të Grupit: plotësimi i raportit të Basel 3 CET 1: 9.3%¹ në 31/12/2012; konfirmimi i objektivit prej > 10% deri në fund të Dhjetorit 2013

Crédit Agricole S.A.

Shërbimet bankare ndaj individëve dhe bizneseve mbeten të forta

E ardhura neto e raportuar e pjesës së Grupit: -€3,982 milion në Q4-12, -€6,471 milion euro në 2012

E ardhura neto e normalizuar e pjesës së Grupit: +€548 milion¹ në Q4-12, +€3,009 milion¹ në 2012

Raporti i Kapitalit 1: 11.7%; Raporti i Kapitalit Kryesor 1: 9.7%² (+110bp / Dhjetor 2011)

Grupi Crédit Agricole*

Performanca të mira krahasuar me Bankat Rajonale

Përmirësim i fortë në raportet e aftësisë paguese të Grupit

E ardhura neto 2012 e pjesës së Grupit: -€3,808 milion, me të ardhurën neto të pjesës së Grupit nga Bankat Rajonale prej +€3,538 milion

Raporti i Kapitalit Kryesor 1: 11.8%¹ (+160bp / Dhjetor 11)

* Crédit Agricole S.A.dhe 100% e Bankave Rajonale

¹ Përpara rivlerësimit të çështjeve të borxhit, Emporiki, Chevreux, plani rregullues, zhvlerësimi i emrit të mirë, zhvlerësimi i letrave me vlerë dhe pagesa e taksës për sigurimin

² Përshtatja për daljen nga konsolidimi të Emporiki

Crédit Agricole S.A.

Bordi i Drejtorëve të Crédit Agricole S.A., kryesuar nga Jean-Marie Sander, u mbledh më 19 Shkurt 2013 për të aprovuar pasqyrat financiare të vitit 2012.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2012 vazhduan përpjekjet e bëra gjatë gjithë vitit, që synonin reduktimin e risqeve përballë Grupit dhe përshtatjen me shpejtësi me mjedisin e ri. Ndikimi i vendimeve të marra në këtë drejtim është reflektuar në rezultatet për tremujorin, i cili tregoi një humbje neto prej -3.982 milion euro (+29,8% krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2011), pasi çështjet specifike të detajuara më poshtë dobësuan të ardhurat neto të normalizuara me + 548 milion euro.

Sipas Jean-Paul Chifflet, Drejtor Ekzekutiv i Credit Agricole S.A., *"Viti 2012 ishte vit transformimi dhe rifokusimi. Ne kemi kthyer një faqe dhe do të zhvillojmë një plan të ri afatmesëm këtë vit. Kjo do të tregojë se ne jemi duke ecur përpara në themele të forta"*.

Jean-Marie Sander, Kryetar i Credit Agricole S.A., theksoi se "Vlefshmëria e modelit bankar universal të Grupit bazuar te klienti mbështetet në fuqinë e shërbimeve bankare me individët dhe pozicionet drejtuese në kursimet e menaxhimit".

E ardhura neto e normalizuar për tremujorin (me përjashtim të çështjeve specifike), prej 548 milion euro, ishte 10% më e lartë se tremujori i katërt i vitit 2011. Në një klimë makroekonomike vazhdimisht të ngadaltë, ajo kryesisht reflekton qëndrueshmërinë e shërbimeve bankare Franceze me individët dhe një performancë të mirë në menaxhimin e Kursimeve, si biznesi kryesor i Grupit. Ajo gjithashtu reflekton përshtatjen e shërmimeve bankare ndaj Korporatave dhe investimeve në një model që është më modest në likuiditete dhe në konsumin e kapitalit. Së fundi, ajo merr parasysh pasojat e kushteve ekonomike në Itali, si dhe ndikimin e reduktimit të kredive të papaguara në financimin e konsumit.

Çështje specifike për tremujorin (-4,530 milion euro) përfshijnë zhvlerësimin e emrit të mirë, zhvlerësimin e letrave me vlerë, ndikimin e rivlerësimit të çështjeve të borxhit, pagesa e taksës dhe efektet e kushteve përfundimtare të shitjes së Emporiki.

Siç tregohet në deklaratën e lëshuar më datë 1 Shkurt, Crédit Agricole S.A. ka kryer testime për te matur vlerën e drejtë të emrit të mirë të paraqitur në bilancin kontabël të saj dhe si rezultat, ajo njohu vlerën totale të zhvlerësimit të pjesës së Grupit prej -2,670 milion euro. Keto reflektojnë kryesisht ndikimin kërkesave më të rrepta paraprake si dhe mjedisin makroekonomik dhe financiar në shtetet dhe bizneset e interesuara. Këto shuma përfshijnë shërbimet per Korporatat dhe investimet (-832 milion euro), financime të konsumit (-923 milion euro) dhe shërbimeve bankare ndërkombëtare me individët (-921 milion euro).

Përveç kësaj, një zhvlerësimi prej 267 milion u regjistrua në lidhje me vlerën prej 20.2% të interesit të kapitalit të mbajtur nga Credit Agricole S.A. në bankën Portugeze BES. Per me teper, sic u njoftua edhe në konferencën për shtyp të datës 25 Janar 2013, zhvlerësimi i vlerës kontabël të aksioneve të SAS Rue La Boétie të njohura në pasqyrat financiare të konsoliduara të Bankave Rajonale pati një ndikim negativ prej 165 milion € në të ardhurën e konsoliduar të Credit Agricole SA-së (ndikim negativ që reduktohet me 40 milion euro nga njohja e ndikimit të bashkimit të Bankave Rajonale në vlerën e aksioneve të tyre).

Të tjera çështje negative të veçanta të përfshira në llogaritë e tremujorit të katërt 2012 janë ndikimi negativ në të ardhurat neto prej -541 milion euro nga rivlerësimi i borxhit të vet (-837 milion euro në të ardhura) për shkak të përmirësimit të kushteve të financimit gjatë tremujorit dhe një shpenzim tatimor prej rreth 128 milion euro në lidhje me tatimin e jashtëzakonshëm 7% mbi rezervën e kapitalizuar të shoqërive të sigurimit.

Së fundi, llogaritë e tremujorit të katërt pasqyrojnë ndikimin e kushteve përfundimtare të shitjes së Emporiki, e cila u mbyll në 1 Shkurt 2013, prej -706 milion euro në të ardhurën neto të pjesës së Grupit. Sipas kushteve të shitjes, nuk ka fond të mbetur dhe si rezultat, provigjonet e konabilizuara në tremujorin e tretë u liruan. Nga ana tjetër, vlerësimi ynë i zbritjes së humbjeve të realizuara në largimin e Emporiki janë modifikuar, në pajtim me reagimin e Qeverisë Franceze të datës 19 Shkurt 2013.

E ardhura neto e pjesës së Grupit për 2012 ishte -6,471 milionë euro. Përveç çështjeve të veçanta të tremujorit të katërt, ajo përfshin ndikimin e vendimeve të marra gjatë tremujorëve të mëparshëm në lidhje me rifokusimin e operacioneve të Credit Agricole S.A. (humbjet e lidhura me Emporiki dhe shitjen e saj, largimi i AK Cheuvreux, largimi i aksioneve në Intesa Sanpaolo, dalja nga konsolidimi i Bankinter, riblerja e borxhit hibrid), si dhe zhvlerësimi i emrit të mirë në financimin e konsumit të rezervuar në tremujorin e tretë.

Gjatë 2012, Grupi ndërmori një sërë masash strategjike madhore. Këto janë kryer në vijim të punës në detaje për të rregulluar mjedisin e ri financiar dhe rregullator si dhe përfshirjen e largimit të bizneseve jo kryesore, rregullimet e vlerësimit në lidhje me aktivet e bilancit kontabël dhe përmirësimin e efikasitetit operativ. Shitja e degës së Emporiki në Greqi u përfundua gjatë gjysmës së dytë të vitit me asnjë linjë financimi të mbetur, ndërsa shuma e papaguar qëndroi në 4.6 miliard euro në fund të muajit Qershor. Në të njëjtën kohë, Grupi rriti përpjekjet e tij për të rifokusuar pasuritë e tij në Evropën Jugore. Ai shiti tërësinë e aksioneve të tij në Intesa Sanpaolo dhe largoi investimin e tij në

BES Vida duke ruajtur interesin pronësor në bankën BES; u ulën investimet e tij në Bankinter me më shumë se 20% në fillim të 2012 deri në 15,1% në fund të vitit, dhe në më pak se 10% që nga ajo kohë.

Riparaqitja e këtyre çështjeve specifike, **në të ardhurat neto të normalizuara** ishte +3,009 milionë euro. Operacionet e shërbimeve bankare Franceze me individët patën një performancë të kënaqshme, pavarësisht ngadalësimit të mprehtë ekonomik, me një rritje prej 5.6% në bilancin e depozitave dhe 1.4% në tepicën e kredisë gjatë vitit. Në Itali, depozitat e konsumatorëve në bilanc u rritën me 5.5%, ndërsa teprica e kredisë së kontraktuar me 1.2%. Menaxhimi i kursimeve përfitoi nga qëndrueshmëria e biznesin në tremujorin e katërt, me hyrjet e reja neto pozitive gjatë vitit të plotë prej 15.2 miliard euro për Amundi dhe prej 1.9 miliardë euro për Sigurimet e Credit Agricole. Në Shërbimet e Specializuara Financiare, të ardhurat patën rënie, në përputhje me objektivat e planit rregullues, ndërsa të ardhurat nga bankingu korporativ dhe investimeve ishin pothuajse të qëndrueshme (nën 3.3%).

Në vitin 2012 plani rregullues i shpallur në Shtator 2011 përfundoi plotësisht me reduktimin e borxhit dhe tejkalimin e synimeve për optimizimin e konsumit të kapitalit. Grupi reduktoi nevojat për financime me 68 miliard euro, pra 136% e objektivit fillestar, dhe aktivet me risk i reduktoi me 57 miliard euro, pra 160% e objektivit të vendosur.

Në vitin 2012, u implementuan disa programe të dizenuara **për shkurtimin e kostove** për të përmirësuar efikasitetin operativ: krahas planit rregullues për CACIB dhe CACF, optimizimit të planit të punës në Cariparma, e cila ishte parashikuar plotësisht në vitin 2012, dhe fillimit të programit të reduktimit kostove të DOMOSDOSHME (650 milion euro deri në 2016) në fushën e informatikës, prokurimit dhe pasurive të paluajtshme, në gjithë grupin Credit Agricole S.A.

Në drejtim **të aftësisë paguese**, Raporti Kryesor i Nivelit 1 (Basel 2.5) i Credit Agricole S.A. ishte 9.7% në fund të Dhjetorit 2012, i rregulluar për daljen nga konsolidimi të Emporiki, e cila do të ndikojë llogaritë në tremujorin e parë 2013. Ai ishte 110 pikë bazë më i lartë krahasuar me 31 Dhjetor 2011. Pjesa më e madhe e këtij përmirësimi ishte për shkak të një reduktimi prej rreth 40 miliard euro në aktivet me risk pas përfundimit të planit të rregulluar.

Duke marrë parasysh rezultatet e 2012 dhe objektivat afatshkurtër të aftësisë paguese, Bordi i Drejtorëve vendosi të mos paraqesë në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionerëve një propozim për pagesë dividendi në lidhje me vitin 2012.

Si një rezultat i caktimit të masave të miratuara për rregullimin e ri bankar dhe kontekstin financiar, Credit Agricole S.A. është pozicionuar mirë për të ofruar një performancë të qëndrueshme financiare.

Grupi Crédit Agricole

Gjatë vitit të plotë 2012, Grupi Credit Agricole, i cili përfshin 100% të fushës së Bankave Rajonale, regjistroi të ardhurën neto të pjesës së Grupit prej -3.808 milion euro. Ky rezultat, i cili u ndikua natyrshëm nga çështje të veçanta të regjistruara nga Credit Agricole S.A., përfshin të gjitha të ardhurat neto të Bankave Rajonale, të cilat u rritën me 3.4% krahasuar me vitin e mëparshëm ose me +3,538 milionë euro.

Rezultatet e Bankave Rajonale reflektojnë një performancë të fortë në një klimë të krizës ekonomike. Depozitat agregate të tyre janë rritur me 4.4% gjatë vitit, duke përfshirë një rritje 5.7% në depozitat në bilanc. Ato regjistruan një rritje prej 1.4% në librin e kredisë dhe 2.2% në kreditë për shtëpi. Raporti kredi-depozita u përmirësua duke u kontraktuar nga 129% në 126% në fund të Dhjetorit 2012. Në tërësi, të ardhurat e Bankave Rajonale u rritën në shkallë vjetore me 2.4%.

Në drejtim të aftësisë paguese, Grupi ka rritur fuqinë e tij financiare me një Raport të Kapitalit Kryesor 1 (Basel 2.5) prej 11.8% në fund të Dhjetorit 2012, të rregulluar pas daljes nga konsolidimi të Emporiki. Raporti u përmirësua me 160 pikë bazë krahasuar me një vit më parë, pjesërisht për shkak të një reduktimi në aktivet e ponderuar me riskun me mbi 42 miliardë euro, sidomos pas përfundimit të planit të rregulluar. Pa marrë parasysh daljen nga konsolidimi të Emporiki, Raporti i Kapitalit Kryesor i nivelit 1 ishte 11.4% në 31 Dhjetor 2012, një përmirësim prej 120 pikë bazë gjatë vitit. Grupi gjithashtu rikonfirmoi objektivin e tij në plotësimin e Raportit të Kapitalit Kryesor të Përbashkët Basel 3 mbi 10% deri në fund të vitit 2013, sipas kërkesave rregullatore dhe duke integruar një zgjidhje efikase që duhet të ndërtohet si një sistem i rendesishëm global (1%). Në fund të Dhjetorit 2012, ky raport ishte 9.3%.

Në fund të dhjetorit 2012, rezerva e parave cash në dispozicion arriti në 230 miliardë euro, krahasuar me 201 miliardë euro në 30 Shtator 2012 dhe 110 miliardë euro në 31 Dhjetor 2011. Teprica mbuloi fondet afatshkurtra të tregut (168%). Teprica burimeve afatgjata të financimit në kërkesat afatgjata të fondeve në 31 Dhjetor 2012 ishte 47 miliardë euro. Për më tepër, Credit Agricole S.A. e shtriu (zgjeroi) programin e vet afatmesëm në një program afatgjatë të tregut, i cili ishte caktuar në 12 miliardë euro për vitin 2012, me 18.8 miliardë euro rritje ndërmjet 1 Janarit dhe 31 Dhjetorit 2012. Çështjet e vendosura nëpërmjet rrjeteve të Grupit dhe fondet shtesë të ngritura që prej 1 Janarit, arritën në vlerën 20.6 miliardë euro në 31 Dhjetor 2012.

Përgjegjësia sociale dhe mjedisore

Në vitin 2012, Credit Agricole S.A. publikoi për herë të parë rezultatet e saj për "Indeksin FReD", i cili mat performancën sociale të Grupit. Indeksi kishte marrë një vlerësim prej 2.4, i cili pasqyron progresin e arritur nga të dhjetë subjektet pjesë në qasjen e Grupit CSR: Amundi, Credit Agricole për Sigurimet, CACEIS, Credit Agricole për Financimin e Konsumatorit, Credit Agricole CIB, Credit Agricole Leasing dhe Factoring, Credit Agricole Bankar Privat Indosuez, Cariparma, Credit Agricole S.A. dhe LCL. Afërsisht 200 plane veprimi janë vlerësuar në një shkallë nga 1 (zgjedhja e planit) deri në 5 (objektivat e arritur). Vlerësimi prej 2.4¹ është vërtetuar nga një palë e tretë si auditues i pavarur, PricewaterhouseCoopers.

FReD është një iniciativë globale për promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve CSR të Grupit. Ajo synon të përhapë praktikën CSR në të gjithë Grupin Crédit Agricole S.A duke angazhuar të gjitha njësitë ekonomike të tij, duke i lënë ata të lirë të zgjedhin prioritetet e tyre në fushat ekonomike, sociale dhe mjedisore. Megjithatë, dy fokuset u përcaktuan për vitin 2012 dhe 2013: menaxhimi i paaftësisë dhe promovimi i barazisë gjinore brenda kompanisë. Objektivi është përfshirja e secilit prej subjekteve të Grupit dhe stimulimi i iniciativave, me FReD duke siguruar një kuadër të përbashkët që lejon subjektet në formalizimin e politikave të tyre CSR dhe një indeks për të krahasuar përparimin e tyre brenda Grupit.

¹ Për Cariparma, llogaritja e realizuar në një periudhë 18-mujore për të marrë parasysh një vonesë në nisjen e procesit në Itali: impakti: ~ 5% në llogaritjen e indeksit të Grupit

Kalendari financiar

7 Maj 2013	2013 rezultatet për tremujorin e parë
23 Maj 2013	Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve
6 Gusht 2013	2013 rezultatet për tremujorin e dytë
7 Nëntor 2013	2013 rezultatet për tremujorin e tretë

Shenim

Ky prezantim mund të përfshijë informacion të ardhshëm për Grupin, i dhënë si informacion mbi tendencat. Këto të dhëna nuk përfaqësojnë parashikime brenda kuptimit të Rregullores Europiane 809/2004 të 29 Prill 2004 (kapitulli 1, neni 2, § 10). Ky Informacion u zhvillua nga skenarët e bazuar në një numër supozimesh ekonomike për një të dhënë konkurruese dhe mjedisi rregullues. Prandaj, këto supozime janë nga natyra subjekt i faktorëve rastësorë që mund të shkaktojnë ndryshime të rezultateve aktuale nga parashikimet. Gjithashtu, pasqyrat financiare janë të bazuara në vlerësime, veçanërisht në llogaritjen e vlerave të tregut dhe rivlerësimin e aktiveve. Lexuesi duhet të marrë në konsideratë të gjithë këta faktorë të riskut dhe pasigurisë përpara marrjes së vendimeve të tyre.

Standardet e aplikueshme dhe krahasueshmëria:

Shifrat e paraqitura për periudhën dymbëdhjetë-mujore që përfundon 31 Dhjetor 2012 janë përgatitur në përputhje me SNRF të miratuara nga Bashkimi Europian dhe në fuqi në atë datë.

REZULTATET E KONSOLIDIMIT TË CRÉDIT AGRICOLE S.A.

(në milion euro)	Q4-12	Ndryshimi Q4/Q4*	2012*	Ndryshimi 2012*/2011*
Të ardhurat	3,326	(23.0%)	16,315	(15.8%)
Shpenzimet operative	(3,120)	(8.5%)	(12,037)	(2.9%)
Fitimi operativ bruto	206	(77.4%)	4,278	(38.8%)
Kosto e riskut	(1,041)	(29.6%)	(3,736)	(12.1%)
Fitimi operativ	(835)	47.0%	542	(80.2%)
Kapitali i filialeve	(156)	(78.5%)	503	x2.2
Të ardhura neto mbi aktive të tjera	111	x14	188	nm
Ndryshimi në vlerën e emrit të mirë	(2,823)	79.2%	(3,395)	x2.2
Fitimi para tatimit	(3,703)	29.5%	(2,162)	nm
Tatimi	255	48.2%	(360)	(59.3%)
Të ardhura neto nga operacionet e mbajtjes-për-shitje	(717)	+89.3%	(3,991)	x2.3
Fitimi neto	(4,165)	+35.8%	(6,513)	x5.4
Interesat e pakicave	(183)	nm	(42)	nm
Fitimi neto i pjesës së Grupit	(3,982)	+29.8%	(6,471)	x4.4

*VF 2011 dhe VF 2012 janë rishikuar për regjistrimin e Emporiki, Chevreux dhe CLSA sipas SNRF 5.

Të ardhurat e Credit Agricole S.A. arritën në 3,326 milionë euro në tremujorin e katërt të vitit 2012. Ato përfshijnë një ndikimi negativ prej 837 milion euro në këtë tremujor nga rivlerësimi i çështjeve të borxhit lidhur me përmirësimin e nisur në Crédit Agricole S.A. Duke përjashtuar këtë ndikim dhe ndikimin jo të favorshëm të 19 milion euro që rezultojnë nga portofoli i largimeve sipas planit të rregulluar, të ardhurat e normalizuara ishin 6.4% më të ulta krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2011. Në vitin e plotë 2012, të ardhurat ishin 16,315 milionë euro, me një rënie prej 15,8% krahasuar me vitin 2011. Përpara çështjeve specifike (rivlerësimi i çështjeve të borxhit dhe portofolit të largimeve sipas planit të rregullues), rënia vjetore ishte në masën 5.7%.

Shpenzimet operative ranë me 8.5% në tremujorin e katërt të vitit 2012 krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2011. Gjatë vitit të plotë, ato arritën në vlerën 12,037 milionë euro, duke rënë me 2.9% në vitin 2011, për shkak të përpjekjeve për të kontrolluar shpenzimet. Duke përjashtuar kostot e kontabilizuara në vitin 2011 për planin të rregullues, shpenzimet operative kishin rënë me 0.2%.

Të ardhurat operacionale bruto ranë me 77.4% nga viti në vit, në tremujorin e katërt të 2012, ose në 206 milionë euro. Rënia ishte 23.5% duke përjashtuar çështjet specifike (rivlerësimi i çështjeve të borxhit dhe ndikimi i planit të rregullimit mbi shërbimet bankare Korporative dhe investimet dhe Shërbimet financiare të specializuara në vitin 2011). Gjatë vitit të plotë, të ardhurat bruto operative bruto ishin 4,278 milionë euro, 38.8% më të ulëta krahasuar me vitin e kaluar, dhe 15% më të ulëta duke përjashtuar çështjet e veçanta.

Kosto e riskut ishte 1,041 milionë euro në tremujorin e katërt të vitit 2012, krahasuar me 1,480 milionë euro në tremujorin e katërt të vitit 2011. Gjatë vitit të plotë, ajo arriti në 3,736 milionë euro.

Në fund të Dhjetorit 2012, niveli i kredive të zhvlerësuar (duke përfshirë qiratë financiare me klientët) ishte 15.6 miliardë euro, ose gati e njëjtë si në fund të vitit 2011 (+0.5%). Kosto e riskut arriti në 3.5% të vlerës bruto të konsumatorëve dhe tepriçës së kredive ndërbankare, krahasuar me 3.3% në fund të Shtatorit 2012 dhe në fund të Dhjetorit 2011. Norma e mbulimit të kredive të zhvlerësuar nga rezervat specifike vazhdoi të rritet, deri në 57.3% në fund të Dhjetorit 2012 nga 56.9% në fund të Shtatorit 2012 dhe 55.4% në 31 Dhjetor 2011. Duke përfshirë rezervat kolektive, norma e mbulimit të kredive të zhvlerësuar ishte 75.7%.

Të ardhurat nga kapitali i filialeve arriten në -156 milion euro në tremujorin e katërt të vitit 2012 dhe +503 milion euro për vitin e plotë. Kjo përfshin ndikimin e zhvlerësimit të aksioneve në in SAS Rue La Boétie dhe SACAM International si dhe rregullimin në vlerësimin e aksioneve që ndoqi bashkimin e Bankave Rajonale. Gjithësej, këto elemente reduktuan kontributin e Bankave Rajonale në të ardhurat e Credit Agricole me 141 milion euro në tremujorin e katërt dhe me 208 milion euro respektivisht gjatë vitit të plotë. Ato gjithashtu përfshijnë 267 milion euro zhvlerësim të ngarkuar për BES në tremujorin e katërt dhe ndikimi nga dalja nga konsolidimi e Bankinter në Gusht 2012 (-193 milionë euro).

Ndryshimi në vlerën e emrit të mirë ishte -3,395 milionë euro në vitin 2012, duke përfshirë -2,823 milionë euro të regjistruara në tremujorin e katërt pas testit të zhvlerësimit dhe nga marrja parasyshe e ndikimit të kërkesave për përforsimin e kujdesit, si dhe mjedisit makroekonomik dhe financiar në vendet përkatëse dhe linjat e biznesit. Vlera e zhvlerësimit e aplikuar për shërbimet bankare ndaj korporatave dhe investimet (-826 milion euro në të ardhurën neto të pjesës së Grupit), financimi i Konsumatorit (-923 milion euro në të ardhurën neto të pjesës së Grupit) dhe shërbimet bankare Ndërkombëtare ndaj individëve (-921 milion euro në të ardhurën neto të pjesës së Grupit).

Në tremujorin e katërt të vitit 2012, **të ardhurat para tatimit** ishin -3,703 milionë euro, ose +486 milion euro duke përfshirë çështjet specifike. Për vitin e plotë, ajo ishte -2,162 milionë euro ose +3,934 milion euro duke përfshirë çështjet specifike.

Të ardhurat neto për operacionet e ndërprerjes ose mbajtjes për shitje erdhën në -717 milion euro në tremujorin e katërt të vitit 2012 (duke përfshirë +127 milion euro që lidhen me kushtet e fundit të shitjes së Emporiki dhe -838 milion euro për trajtimin tatimor të transaksionit), dhe -3,991 milion euro gjatë vitit të plotë, që reflektojnë progres të bërë nga shitja e Emporiki, Cheuvreux dhe CLSA.

Të ardhurat neto të pjesës së Grupit Credit Agricole S.A. ishin -3,982 milionë euro në tremujorin e katërt të vitit 2012. Duke përfshirë çështjet e veçanta (rivlerësimi i çështjeve të borxheve të veta, zhvlerësimi i emrit të mirë, zhvlerësimi i aksioneve në SAS Boétie Rue La dhe BES, shitja e Emporiki dhe pagesa e tatimit), ato ishin 548 milion euro, një rritje prej 10% krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2011 në një bazë të normalizuar.

Përfundimi i Planit të Rregullimit: nevojat për financim dhe reduktimi i ndjeshëm i aktiveve të ponderuar me riskun

Grupi vazhdoi në mënyrë aktive zbatimin e planit të rregullimit të shpallur më 14 Dhjetor 2011 dhe tejkalimin e objektivave fillestarë të tij, në drejtim të reduktimit të borxhit dhe optimizimit të konsumit të kapitalit. Në përputhje me rrethanat, Grupi reduktoi kërkesat për likuiditet me 68 miliardë euro me kursin aktual të këmbimit ndërmjet Qershor 2011 dhe Dhjetor 2012, pra ka arritur 136% të objektivit të tij 50 miliardë euro. Gjatë së njëjtës periudhë, aktivet e ponderuara me riskun janë ulur me 57 miliardë euro me kursin konstant të këmbimit (që përfaqëson 160% të objektivit), duke përfshirë ndikimet e Basel 3 si dhe transaksionin Marylebone të cilët shkurtojnë aktivet e ponderuara me riskun me 14 miliardë euro.

Këto reduktime pasqyrojnë masat e marra brenda tre linjave të biznesit. Në shërbimet bankare me individë, raportin e përmirësuar ndjeshëm kredi-depozita, kontraktimin nga 129% në Qershor 2011 deri në 122% në fund të Dhjetorit 2012.

¹ Parashikimi përjashton Emporiki, CA Cheuvreux dhe CLSA të riklasifikuara sipas SNRF 5.

Shërbimet e specializuara financiare ulën kërkesat e tij kryen me sukses veprime të rifinancimit të jashtëm nëpërmjet mbledhjes së depozitave nga individët në Gjermani, letrave me vlerë dhe obligacioneve, të cilat gjeneruan 7 miliardë të depozitave gjatë kohëzgjatjes së planit, duke përfshirë 2 miliardë euro në tremujorin e katërt të vitit 2012. Së fundmi, përveç zbatimit të modelit të tij të ri, Crédit Agricole CIB shiti 10.3 miliardë euro të portofolit të kredive (me një zbritje mesatare prej vetëm 2.3%), duke përfshirë 0.4 miliardë euro në tremujorin e katërt të vitit 2012, si dhe portofolët CDO dhe RMBS dhe riskut të tregut për korrelacionin e portofolit.

	Financimi	Aftësia Paguese
(€ bn)	Reduktimi në nevojat për financim më 31/12/2012 ⁽¹⁾	Reduktimi në aktivet e ponderuar me riskun më 31/12/2012 ⁽²⁾
Shërbimet bankare me individë	- 22	
SFS	- 13	- 6
CIB	- 33	-51
Totali	- 68	-57

(1) Me normat aktuale të këmbimit

(2) Me normat konstante të këmbimit, duke përfshirë ndikimin nën Basel 3

STRUKTURA FINANCIARE

Crédit Agricole S.A. ka rritur më tej fuqinë e saj financiare në vitin 2012, duke rritur Raportin e Kapitalit Kryesor të saj te nivelit 1 në 9,2% në 31 Dhjetor 2012 nga 8.6% në 31 Dhjetor 2011.

Gjatë periudhës, Credit Agricole S.A. ka regjistruar efektin pozitiv të rritjes së të ardhurave të përcaktuara (50 pikë bazë), vazhdimi i planit të rregullimit në shërbimet bankare për korporatat dhe investimet dhe shërbimet e Specializuara financiare (54 pikë bazë), dhe përfundimi i nxjerrjes jashtë të riskut të tregut në korrelacionin e regjistruar të CACIB (49 pikë bazë). Nga ana tjetër, humbja në shitjen e Emporiki ka kontribuar ndjeshëm në ndryshimin negativ prej 93 pikë bazë në fitimet e pashpërndara (duke përjashtuar zhvlerësimin e emrit të mirë). Nga kjo, rreth 50 pikë bazë do të kompensohet në tremujorin e parë të vitit 2013 nga dalja nga konsolidimi i aktiveve të ponderuar me riskun të filialit Grek.

Në vitin 2012, aktivet e ponderuar me riskun ranë me 40.6 miliardë euro (përfshirë 5.2 miliardë euro në tremujorin e katërt), kryesisht për shkak të planit të rregullimit dhe transferimi i riskut të tregut të korrelacionit të regjistruar. Ato ranë nga 333.7 miliardë euro më 31 Dhjetor 2011 në 293.1 miliardë euro në 31 Dhjetor 2012.

Në tremujorin e katërt vetëm, Raporti i Kapitalit Kryesor i nivelit 1 u ul me 10 pikë bazë. Duke parashikuar daljen nga konsolidimi të aktiveve të ponderuara me riskun të Emporiki, të cilat do të ndodhin me mbylljen e transaksionit në tremujorin e parë të vitit 2013, Raporti i Kapitalit Kryesor 1 do të jetë 9,7% i parashikuar.

LIKUIDITETI

Gjendja në bilanc e cashit për Grupin Crédit Agricole arriti në 1,032 miliardë euro në fund të Dhjetorit 2012, 2 miliardë euro më shumë se në fund të Dhjetorit 2011.

Borxhi afatshkurtër, që korrespondon me tepricën e borxhit të pashlyer brenda 370 ditëve të ngritur nga Grupi për palët e tregut (duke përjashtuar rrjetet e repove dhe repot e anasjellta dhe duke përjashtuar rifinancimin e Bankës Qendrore që arrin 34 miliardë euro), arriti në 137 miliardë euro në 31 Dhjetor 2012, krahasuar me 136 miliardë euro në 31 Dhjetor 2011. Fondet afatshkurtra të tregut dhe rënia e repove me 12 miliard euro gjatë vitit, ndërsa aktivet likuide, kryesisht depozitat me Bankat Qendrore, aktivet ndërbankare dhe portofoli i letrave me vlerë, janë rritur nga 36 miliard euro gjatë vitit.

Teprica e burimeve afatgjata të financimit mbi aplikimet e fondeve afatgjata në 31 Dhjetor 2012 ishte 47 miliardë euro. Burimet afatgjata të financimit arritën në 861 miliardë euro në 31 Dhjetor 2012 dhe përbënin fondet afatgjatë të tregut, fondet e lidhura me konsumatorët dhe kapitalin (dhe çështje të ngjashme). Burimet afatgjata të financimit janë rritur me 14

miliardë euro ndërmjet 31 Dhjetorit 2011 dhe 31 Dhjetorit 2012. Kërkesat për financim në lidhje me aktivet e lidhura me konsumatorët, si dhe aktivet e trupezuara dhe të patruazuara arritën në 814 miliardë euro në 31 Dhjetor 2012, 34 miliardë euro më pak se në 31 Dhjetor 2011.

Ulja prej 68 miliardë euro në kërkesat për financim të arritura në kuadër të planit rregullues përbëhet nga ulja 21 miliardë euro e regjistruar në fund të vitit 2011 dhe një reduktim 47 miliardë euro në 2012. Këto 47 miliardë euro rezultojnë kryesisht nga një rritje në financimet e lidhura me konsumatorët (23 miliardë euro) dhe një reduktim në aktivet dhe asetet dhe aktivet e tregëtueshme të lidhura me konsumatorët (27 miliardë euro).

Rezervat e aktiveve në dispozicion (pas ndërprerjes) që kualifikohen për rifinancimin e Bankës Qendrore ose që mund të shndërrohen në para në treg, duke përfshirë depozitat e Bankës Qendrore, arritën 230 miliardë euro në fund të Dhjetorit 2012. Ato ishin 29 miliardë euro më të larta se në fund të Shtatorit 2012. Ato gjerësisht mbuluan fondet afatshkurtra të tregut (168%), të cilët arritën në 137 miliardë euro në fund të 2012.

Rezervat në dispozicion përbëhen prej 95 miliard euro në letra me vlerë të tregut të likuiditeteve gjithashtu të kualifikuara për rifinancim të Banka Qëndrore (41% e rezervës totale), 15 miliardë euro në letra me vlerë të tregut të likuiditeteve (7%), 53 miliardë euro në depozita me Bankat Qëndrore (23%), 58 miliardë euro në aktive që kualifikohen për rifinancim të Bankës Qendrore (25%) dhe 9 miliardë euro në letrave me vlerë dhe këste të vetë-sigurimit (4%) që kualifikohen për rifinancimin e Bankës Qendrore.

Për sa i përket financimit afatmesëm/ afatgjatë, Credit Agricole S.A. ka tejkaluar programin e zhvilluar në tregun e saj i cili ishte vendosur në 12 miliard euro për vitin 2012, me 18.8 miliardë euro rritje ndërmjet 1 Janarit dhe 31 Dhjetorit 2012. Afati mesatar i çështjeve është 6.3 vjet dhe përhapja mesatare është 121,9 pikë bazë kundrejt mid-swap. Programi i financimit 2013 afatmesëm/ afatgjatë të Credit Agricole S.A. është 12 miliardë euro, në të njëjtin nivel si programi 2012.

Njëkohësisht, Grupi po zhvillon qasjen e tij ndaj burimeve të tjera të financimit nëpërmjet rrjeteve bankare të shërbimeve me individë dhe filialeve të specializuara të saj, veçanërisht përmes dhenies të borxhit. Më 31 Dhjetor 2012, 3.7 miliardë euro ishin arritur nëpërmjet rrjetit të Bankave Rajonale, 4.9 miliardë euro nëpërmjet LCL dhe rrjeteve Cariparma, 7.6 miliardë euro nëpërmjet Credit Agricole CIB (kryesisht në vendosje private të strukturuar) dhe 4.4 miliardë euro nëpërmjet Financimit të Konsumatorëve të Credit Agricole (kryesisht hua dhe letra me vlerë). Totali i financimeve afatmesme dhe afatgjata të kryera nëpërmjet rrjeteve të shërbimeve bankare me individë të Grupit dhe me degë të specializuara arriti në 20.6 miliardë euro në vitin 2012.

REZULTATET SIPAS LINJAVE TË BIZNESIT

1. SHËRBIMET BANKARE FRANCEZE ME INDIVIDË

Në tremujorin e katërt të 2012, shërbimet bankare franceze ndaj individëve (retail banking) qëndruan rezistente në një ekonomi Franceze të zhvillimit të ngadaltë. Rrjeti i degëve vazhdoi të gëzojë një situatë solide, me rritje të depozitave në bilanc me 5.6% krahasuar me periudhën e një viti më parë, ose në 413.7 miliardë euro në 31 Dhjetor 2012. Kjo ecuri e mirë është një përzierje pjesërisht për shkak të ndryshimit në favor të rregullimit në llogaritë e librazave bankare, të cilat tërhoqën depozitat prej 12,0 miliardë euro në tremujorin e katërt vetëm për shkak të tavanit të lartë për Livret A dhe llogaritë e librezave bankare LDD. Rritja e konsiderueshme në interes që mbajnë depozitat është nxitur gjithashtu nga një rritje në llogaritë dhe depozitat me afat, e cila u rrit me 18.7% në krahasim me 31 Dhjetor 2011.

Në të njëjtën kohë, depozitat jashtë bilancit kanë vazhduar të rimerren, duke u rritur me 2.6% nga viti në vit, për shkak të një efekti pozitiv në treg dhe rinovimit të interesit në sigurimin e jetës. Ato arritën në 317.3 miliardë euro në 31 Dhjetor 2012.

Teprica e kredisë u rrit me 1.4% nga viti në vit deri në 485.2 miliardë euro në 31 Dhjetor 2012.

Raporti kredi-depozita qëndroi në 124% në 31 Dhjetor 2012, krahasuar me 130% në 30 Qershor 2011, duke u përmirësuar me gjashtë pikë përqindje në krahasim me fillimin e planit rregullues. Ky raport ishte 126% në fund të Dhjetorit 2011.

Kontributi në të ardhurat operative i Bankave Rajonale ishte 210 milion euro në tremujorin e katërt të vitit 2012. Kontributi u reduktua në 69 milion euro pas zhvlerësimit të aksioneve të SAS Rue La Boétie (-165 milion euro), rregullimi i vlerësimit për aksionet pas bashkimit të Bankave Rajonale (+40 milion euro) dhe zhvlerësimit të aksioneve ndërkombëtare SACAM (-16 milion euro). Kontributi i LCL ishte 123 milion euro, i ulur me 5.8% nga viti në vit në tremujorin e katërt të 2012.

Në total, e ardhura neto e linjave operative të biznesit për pjesën e Grupit ishte 333 milion euro në tremujorin e katërt dhe 1,695 milionë euro gjatë këtij viti, deri në 0,7% në 2011.

1.1. BANKAT RAJONALE TË CRÉDIT AGRICOLE

(në miliona euro)	Q4-12	Ndryshimi Q4/Q4	2012	Ndryshimi 2012/2011
Fitimi neto llogaritet sipas metodës së kapitalit neto (rreth 25%)	72	(66.7%)	674	(21.1%)
Ndryshimi në pjesën e rezervave	(3)	nm	150	(2.6%)
Kapitali i filialeve	69	(68.3%)	824	(18.4%)

Në tremujorin e katërt të 2012, Bankat Rajonale vazhduan të ndjekin strategjinë e tyre për arritjen e rritjes së balancuar në bizneset e tyre.

Ato mbajtën një performancë përgjithësisht të fortë në depozita, të cilat u rriten me 4.4%, krahasuar me një vit më parë, deri në 574.3 miliardë euro. Depozitat në bilanc u rritën me 5.7% krahasuar me një vit më parë, në 333.7 miliardë euro. Rritja është nxitur kryesisht nga llogaritë dhe depozitat me afat (+18,1%) dhe llogaritë e librezave bankare (10,8%), kryesisht llogaritë e librezave bankare të rregulluara Livret A dhe LDD, të cilat kanë përfituar nga rritja e tavanëve të tyre që nga 1 Tetor 2012. Këto depozita mblodhën 10.5 miliardë euro vetëm në tremujorin e katërt, ose 21.6% më shumë se në tremujorin e tretë të vitit 2012. Në të njëjtën kohë, Bankat Rajonale mbajtën një situatë solide të drejtuar nga një efekt pozitiv në treg të depozitave jashtë bilancit, të cilat u rritën me 2.6% krahasuar me një vit më parë, në shumen 240.6 miliardë euro në fund të Dhjetorit 2012. Në letrë me vlerë performanca ishte e dukshme, me aktivet e konsumatorëve në rritje me 13.3% krahasuar me një vit më parë. Sigurimi i jetës gjithashtu përfitoi nga një efekt pozitiv (+2,0% krahasuar me një vit më parë).

Teprica e kredisë arriti në 396,0 miliardë euro në 31 Dhjetor 2012, 1.4% më shumë në krahasim me 31 Dhjetor 2011. Rritja e kredive për shtëpi u ngadalësua por përsëri mbeti e kënaqshme me rritje +2,2%.

Si rezultat i kësaj, raporti kredi-depozita u përmirësua në 126% në fund të Dhjetor 2012 nga 129% në fund të Dhjetorit 2011.

Të ardhurat e bankave Rajonale (të riparaqitura për transaksionet brenda grupit) arriten në 2,915 miliard euro në tremujorin e katërt të 2012, duke rënë me 12,2% në tremujorin e katërt të 2011. Rënia reflekton njohje në llogaritë e Bankave Rajonale të zhvlerësimit të aksioneve për SAS Rue La Boétie pas ndryshimit në metodën e vlerësimit të aksioneve (-650 milion euro), duke zbritur një rregullim prej 161 milion euro për rimarrjen e fshirjeve të rivlerësimit të aksioneve "CNCA" në periudhën e shkrirjes së disa Bankave Rajonale. Së fundi, të ardhurat pasqyrojnë zhvlerësimin e aksioneve ndërkombëtare SACAM (62 milion euro). Duke përjashtuar këto çështje dhe ndikimin e planeve të kursimit për blerje shtëpie, të ardhurat do të ishin rritur me 4.1% krahasuar me periudhën e vitit të kaluar në tremujorin e katërt të vitit 2012 dhe 1.5% gjatë vitit të plotë.

Shpenzimet ishin 6.5% më të larta në tremujorin e katërt të vitit 2012 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ato përfshijnë taksat e reja të miratuara në vitin 2012 si pjesë e Ndryshimit të Aktit të Financave dhe Aktit për Fondin e Sigurimeve Sociale, dhe një rritje prej 223 milion euro për shkak të projektit NICE, pak mbi nivelin e 209 milion euro të regjistruar në vitin 2011. Përpara se ndikimi i taksave të reja të votuara në vitin 2012 në kuadrin e Ndryshimit të Aktin e Financave dhe rritja e investimeve për shkak të projektit NICE (+14 milion euro në tremujorin e katërt të vitit 2012), kanë qenë deri në 3.9% krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2011.

Të ardhurat operative ishin 735 milion euro në tremujorin e katërt të vitit 2012 duke marrë në konsideratë koston e riskut prej 150 milionë euro, përkatësisht 15 pikë bazë të tepicës së kredisë në tremujorin e katërt të vitit 2012 në krahasim me një vlerë të ulët 4 pikë bazë në tremujorin e katërt të vitit 2011. Raporti i zhvlerësimit të kredisë ishte 2.4% në fund të Dhjetorit 2012 dhe ka qenë i qëndrueshëm që nga fundi i vitit 2010. Raporti i mbulimit (duke përfshirë rezervat kolektive) ka mbetur i lartë në 107,6% në fund të Dhjetor 2012 krahasuar me 108,8% në fund të Dhjetorit 2011.

Si pasojë, kontributi i Bankave Rajonale në të ardhurën neto të pjesës së Grupit të Credit Agricole S.A. ishte 69 milion euro në tremujorin e katërt të vitit 2012, 68.3% më i ulët se në tremujorin e katërt të vitit 2011. Duke përjashtuar efektet negative të zhvlerësimeve dhe përshtatjes së vlerësimit të aksioneve, ajo do të kishte qenë 210 milion euro. Për 2012, kontributi i Bankave Rajonale në të ardhurën neto të pjesës së Grupit të Credit Agricole S.A. arriti në vlerën 824 milion euro. Ajo do të arrijë në 1,032 milionë euro e rishikuar për ndikime të njëjta, deri në 1.9% krahasuar me vitin 2011.

1.2. LCL

(ne milione euro)	T4-12	Diferenc T4/T4	2012	Diferenc 2012/2011
Te ardhurat	919	(0.2%)	3,891	+ 1.8%
Shpenzimet operative	(639)	(0.4%)	(2,522)	+ 1.0%
Fitimi operativ bruto	280	+ 0.1%	1,369	+ 3.3%
Kosto e riskut	(77)	+ 10.5%	(311)	+ 8.6%
Fitimi operativ	203	(3.4%)	1,058	+ 1.8%
Te ardhura neto nga asete të tjera	2	nm	1	nm
Fitimi para tatimit	205	(3.2%)	1,059	+ 1.8%
Tatimi	(75)	+ 1.5%	(361)	+ 9.5%
Fitimi neto	130	(5.7%)	698	(1.8%)
Interesat e pakices	7	(4.4%)	35	(1.4%)
Pjesa e te ardhurave neto te grupit	123	(5.8%)	663	(1.8%)

Gjate tremujorit te katert, LCL vazhdoi te ofronte mbeshtetje per individet, korporatat dhe bizneset e vogla. Kredite e pazgjdhura per shtepi levizen mbi 0.9% nga njeri tremujor ne tjetrin ne tremujorin e katert te 2012, pavaresisht kerkeses me te ulet, me nje rritje nga viti ne vit prej 3.0%, duke i cuar kredite e pazgjdhura totale mbi 1.6%, ose ne 89.2 miliarde euro.

Njekohesisht, rritja e balancuar u rivendos ne depozitat konsumatore ne dhe jashte bilancit gjate vitit, me hyrje te reja pozitive ne sigurimet e jetes ne vazhdim gjate tremujorit te katert. Per shkak te ketij momenti te qendrueshem ne fund te vitit pati nje efekt tregu pozitiv, fondet e sigurimit te jetes nen menaxhim u rriten me 5.4% nga viti ne vit. Depozitat totale arriten nje vlere prej 156.7 miliarde euro ne 31 Dhjetor 2012, me rritje 3.9% nga viti ne vit, me rritje prej 5.0% ne depozitat ne bilanc dhe prej 2.8% ne depozitat jashte bilancit ne te njejten periodhe.

Raporti hua depozita ishte 116% ne fund te Dhjetorit 2012, i qendrueshem gjate gjithë vitit pervec kufirit te ri maksimal me te larte Livret A dhe LDD llogarite e kursimit ne tremujorin e katert te 2012. Qe nga fundi i Qershorit 2011 dhe implementimi i planit rregullues, raporti hua depozita eshte permiresuar me 13 pike.

Te ardhurat per tremujorin e katert ishin 919 milion euro, pothuajse te njejta me tremujorin e katert te 2011 (-0.2%), per shkak te marzheve fleksibel, te cilat u rriten me 2.3% nga viti ne vit ne tremujorin e katert te 2012. Ne te kundert, te ardhurat nga tarifat dhe komisionet jane ndikuar negativisht nga renia e vellimit te transaksioneve te konsumatoreve me letrat me vlere dhe u reduktuan me 3.4% nga viti ne vit ne tremujorin e katert.

Shpenzimet operative ne tremujorin e katert te 2012, duke perjashtuar impaktin e taksave te reja te vendosura si pjese e Aktit Financiar te ndryshuar dhe Aktit Themeltar te Sigurimeve Shoqerore, ishin 3.4% me te uleta se ne tremujorin e katert te 2011. Edhe duke perfshire kete impakt jofavorizues, ato mbeten te kontrolluara ne menyre strikte, me nje renie prej 0.4% ne te njejten periodhe.

Te ardhurat operative bruto ndryshuan me 0.1% nga viti ne vit ne tremujorin e katert te 2012 dhe me 3.3% gjate gjithë vitit. Si rezultat i ketyre dy faktoreve, raporti kosto/te ardhura u permiresua ne tremujorin e katert te 2012 ne 69.6%, duke rrene me 0.1 pike perqindje krahasuar me nje vit me pare.

Kostoja e riskut u rrit 10.5% nga viti ne vit ne tremujorin e katert te 2012. Megjithate, raporti i huave te zhvleresuara mbeti i qendrueshem ne 2.4%, ndersa raporti i mbulimit, duke perfshire rezervat kolektive, u rrit ne 76.8% nga 75.5% ne fund te Dhjetorit 2011.

Ne total, te ardhurat neto, pjesa e grupit ishin 123 milion euro ne tremujorin e katert te 2012, me renie 5.8% krahasuar me tremujorin e katert te 2011. Per 2012, pjesa e te ardhurave neto te grupit ishte 663 milion euro, me nje renie vetem prej 1.8%.

2. BANKINGU NDERKOMBETAR ME INDIVIDET

Shitja e Emporiki, e cila u njoftua ne Tetor, u mbyll ne 1 Shkurt 2013. Ne 31 Dhjetor 2012, Emporiki figuronte ne librat e Crédit Agricole S.A., e regjistruar sipas IFRS 5 nen te njejtat kushte si ne 30 Shtator 2012.

(ne milione euro)	T4-12	Diferenc T4/T4*	2012*	Diferenc 12/11*
Te ardhurat	611	+5.5%	2,472	+3.9%
Shpenzimet operative	(478)	+14.7%	(1,707)	+8.9%
Fitimi operativ bruto	133	(18.2%)	765	(5.8%)
Kosto e riskut	(162)	+20.4%	(522)	+18.4%
Fitimi operativ	(29)	Nm	243	(34.5%)
Kapitali i filialeve	(257)	(73.7%)	(393)	(56.9%)
Te ardhura neto nga asetete tjera	(1)	Nm	(3)	nm
Ndryshimi në vlerë i emrit të mirë	(1,066)	x3.9	(1,066)	x3.9
Fitimi para tatimit	(1,353)	+10.6%	(1,219)	49.6%
Tatimi	22	(48.5%)	(50)	(40.2%)
Fitimi neto nga operacionet e mbajtura per shitje	(709)	nm	(3,742)	x2.3
Fitimi neto	(2,040)	36.4%	(5,011)	+99.7%
Interesat e pakices	(145)	x7.5	131	x2.6
Pjesa e te ardhurave neto te grupit	(1,895)	28.3%	(4,880)	+98.5%

*FY 2011 dhe FY 2012 jane riparaqitur per regjistrimin e Emporiki sipas IFRS 5

Ne Itali, Cariparma pati rritje edhe pse ne nje klime ekonomike me veshtiresi te vazhdueshme.

Teprica e kredive kapi vleren prej 33.4 miliarde euro ne 31 Dhjetor 2012, me nje renie prej 1.2% krahasuar me 31 Dhjetor 2011, ose me pak se renia mesatare e tregut prej 2.9%¹. Depozitat totale u rriten me 5.5% nga viti ne vit ne 35.6 miliarde euro, nderkohe qe tregu regjistroi nje renie prej 3.5%¹. Si rezultat, Cariparma gjeneroi nje teprice likuiditeti qe kontribuoi ne themelimin e bizneseve te tjera te grupit ne Itali.

Te ardhurat u rriten me 4.5% nga viti ne vit ne tremujorin e katert te 2012, mbi baza te favorshme ne krahasim me tremujorin e katert te 2011. Kjo ecuri eshte gjithashtu per shkak te te ardhurave elastike nga tarifat dhe komisionet. Gjate vitit, rritja e te ardhurave u rrit me 2.6 %.

Tremujori i katert ishte ndikuar nga zgjerimi i planit vullnetar te nisjes te themeluar ne gjysmen e pare te 2012, me 64 milion euro te regjistruara ne provizione per koston e ketij plani ne tremujorin e katert te 2012, si shtese e 54 milion euro te regjistruara ne tremujorin e dyte te 2012. Sipas planit, nje total prej 720 punonjesisht pritet te largohen deri ne 2015. Ne total, shpenzimet operative² u rriten me 2.2% nga viti ne vit ne tremujorin e katert te 2012 dhe me 0.9% gjate vitit.

¹ Burimi: Shoqata Italiane e bankave

² Duke perjashtuar koston e planit vullnetar te nisjes (PDV) ne T2-12, dhe ne T4-12, efektin e ndryshimeve ne qellim dhe koston e lidhura me integrimin ne 2011

